

18.03.2021  
Ora 11:27

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Plarent Xhorxhi Aleksi si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:      **Z.Y.Merkaj, O.Peto, M.Koja**

• **Parti Politike:**

**BD, PBK, ABEOK**

**Z.I.Celibashi:** Mirëdita të gjithëve. Në seancën e ditës së sotme kemi këto çeshtje në rendin e ditës, projektvendimin:

1.“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Plarent Xhorxhi Aleksi si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;

2.“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Pal Marash Shkambi si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”;

3.“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të Partisë Aleanca Demokracia e Re, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”;

4.“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të Partisë Bindja Demokratike, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”;

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

- 5.“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”;
  - 6.“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të Partisë Balli Kombëtar, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”;
  - 7.“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të koalicionit Aleanca për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”;
  - 8.“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të Partisë Aleanca Kombëtare, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”;
  - 9.“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”;
- Atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

**Z.Y.Merkaj:** KQZ në datën 5.02.2021 ka regjistruar Komitetin Nismëtar i cili do të organizojë punën për mbledhjen e firmave mbështetëse për paraqitjen e zotit Plarent Aleski si kandidatë i propozuar nga zgjedhësit për zonën zgjedhore Qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Në datën 23.02.2021 Komiteti Nismëtar ka paraqitur pranë KQZ-së nënshrimet mbështetëse të 1034 kandidatëve për të cilët shprehet se janë përfshirë me faktin e përbërësve zgjedhor zona zgjedhore Qarku Berat. Bashkëlidhur keni dokumentacioni dhe rezultoni se janë 184340 zgjedhës. Numri i zgjedhësve që i korespondon kufirit minimal prej 1% të listës së zgjedhësve është 1843. KQZ i ka kërkuar Komitetit Nismëtar me zotin Plarent Aleksi korigjim për plotësim dokumentacioni sipas pikës së nënit 69 të Kodit Zgjedhor. Brenda afatit të përcaktuar nga KQZ, Komiteti Nismëtar nuk ka depozituar dokumentacionin e korigjuar. Pas verifikimit të

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

dokumentacionit në tërësi konstatohet se dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 69, 72 dhe 73 të “Kodit Zgjedhor”. Në mbështetje të neneve të mësipërme i propozojë KQZ-së të mos regjistrojë zotin Plarent Aleksi si kandidatë i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, falemindert.

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit zoti Sekretar. Për diskutime, përfaqësuesi i Komitetit, është prezent? Nuk ka. Mirë, atëherë bazuar në relatimin e bërë nga Administrata dhe nenit 19 pika 1 shkronja “n” dhe 2 si dhe neni 69.71.72,73 të “Kodit Zgjedhor”, udhëzimit numër 1 datë 23.12.2020 për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve, miratimin e modeleve të kandidimit, vendos:

- 1.Të refuzojë kërkesën për regjistrim të zotit Plarent Aleksi si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”;
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e KQZ-së;
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, faleminderit.

**Vendimi nr.159**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Silvi Sino*



18.03.2021  
Ora 11:32

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Pal Marash Shkambi, si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:                                      **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto**
- **Parti Politike:**                                **BD (F.Topollaj, PBK (E.Alimadhi)**
- **Koalicione:**                                    **ALEANCA (D.Mullahaj), ABEOK (K.Papa)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 05.02.2021, ka regjistruar Komitetin Nismëtar, i cili organizoi punën për mbledhjen e firmave mbështetëse për paraqitjen e zotit Pal Shkambi, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Shkodër për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Në datën 03.02.2021 Komiteti Nismëtar, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nënshkrimet mbështetëse të 1860 zgjedhësve për të cilët shprehen se janë përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhor në zonën zgjedhore Qarku Shkodër. Referuar ekstraktit më të fundit të listës zgjedhore Qarku Shkodër, rezulton se ka 274 mijë e 230 zgjedhës. Sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 69 të Kodit Zgjedhor, numri i zgjedhësve që i korespondon kufijtë minimal për 1% të listës së zgjedhësve është 2743 zgjedhës.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka kërkuar Komitetit Nismëtar dhe zoti Pal Shkambi korigjim dhe plotësim të dokumentacionit sipas pikës 8 të nenit 69 të Kodit Zgjedhor. Brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është plotësuar dokumentacioni janë depozituar 2766 nënshkrime. Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se është në përputhje me nenin 69 të Kodit Zgjedhor. Në mbështetje të nenit 71 pika 3 të Kodit Zgjedhor, për depozitimin e verifikimit të dokumentacionit të kandidatit afatet të publikimit të listave Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka ftuar dhe Komitetin Nismëtar për të qenë prezent në seancë publike. Pas verifikimit të listave mbështetëse të zonës zgjedhore për Qarkun Shkodër për të cilat rezultojnë gjithsej të dorëzuara 2766 nënshkrime për të cilat janë bashkëlidhura edhe kopjet e letërnjoftimeve. Administrata e KQZ-së ka bërë verifikimin dhe ka përzgjedhur në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista zgjedhore mbështetëse dhe numri i zgjedhësve të verifikuar është 135 zgjedhës. Në përfundim të verifikimit duke përjashtuar dhe numrin e shkrimit të parregullta, rezulton se është më i madh se numri i kërkuar minimal e kërkuar në bazë të nenit 70, pika 3 e Kodit Zgjedhor për nënshkrimet. Gjithashtu kandidati për deputet ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit ku pas verifikimit të formularit të vetëdeklarimit konstatohet se nuk ka asnjë ndalim nuk është në kushtet e ndalimit neni 138 të vitit 2015. Në këto kushte duke qenë se dokumentacioni i paraqitur nga kandidati për deputet për Qarkun Shkodër është në përputhje neni 69, 72 dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor i propozoj Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve regjistrimin e zotit Pal Shkambi si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për zonën zgjedhore Qarku Shkodër për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, diskutime në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës?

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

**Z. P. Shkambi, kandidat i pavarur:** Faleminderit zoti kryetar. Unë Pal Shkambi, realisht isha anëtar i Komisionit të Pavarur të kualifikimit. Kam dhënë dorëheqjen në afat të caktuar. Kam mbledhur firma shtëpi për shtëpi dhe në qytet. Është vonuar shumë procesi për të më dhënë këtë të drejtë, sepse të tjerët kanë filluar fushatën me të drejtë dhe të padrejtë, me media e shtëpi në shtëpi. Me thënë të drejtën një farë mënyre unë jam diskriminuar por megjithatë unë do ta pranoj këtë gjë dhe do të punoj me ritëm edhe për këtë vonesë që kam pasur.

**Z. I. Celibashi:** Përsa u relatua nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe bazuar në nenin 19, pika 1 shkronja “n” dhe pika 2, neni 69 dhe neni 71, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si Udhëzimi nr.1 datë 21.12.2020, për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit si dhe shkronjës “a”, të pikës 4 të nenit 5 të ligjit 138/2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, numërohen ose ushtrojnë funksionet publike vendos:

Të regjistrojë zotin Pal Marash Shkambi, si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Shkodër për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr.160**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



**18.03.2021  
Ora 11:37**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumëemërore të Partisë Aleanca Demokracia e Re, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

**1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      Z.Illirjan Celibashi**

**2.Stafi KQZ:                                      Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto**

• **Parti Politike:                                      BD (F.Topollaj), PBK (E.Alimadhi)**

**Koalicione:                                      ALEANCA (D.Mullahaj), ABEOK (K.Papa)**

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z.Y.Merkaj:** Partia Aleanca Demokracia e Re, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021. Ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dokumentacionin për miratimin e listave shumëemërore, në datën 08.03.2021. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 10.03.2021 ka kthyer për korrigjim, dokumentacionin e listës shumëemërore të kandidatëve për deputetë të subjektit zgjedhor, Partia Aleanca Demokracia e Re. Brenda afatit ligjor, të përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ky subjekt zgjedhor ka depozituar dokumentacionin e korrigjuar. Me mbështetjen e nenit 73, të Kodit Zgjedhor, është bërë verifikimi i listave shumëemërore të kandidatëve për deputetë, të këtij subjekti zgjedhor dhe dokumentacionin përkatës, dhe është

**Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

konstatuar se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara me nenin 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Në përputhje me nenin 8, të ligjit nr.138, të vitit 2015, për dekriminalizimin, kandidatët për deputetë të subjektit zgjedhor, Partia Aleanca Demokracia e Re, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit rezulton se, asnjë nga kandidatët nuk kanë deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me parashikimet për ndalim në ligjin nr.138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka verifikuar gjendjen gjyqësore të kandidatëve dhe rezulton se janë të padënuar, nga gjykatat shqiptare. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë. Referuar ligjit nr.138, të vitit 2015, të dhënat e deklaruara në formularët e vetëdeklarimit dhe informacioni i ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për kandidatët për deputetë të subjektit politik, Partia Aleanca Demokracia e Re, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021. Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës së dokumentacionit, të listave shumëemërore, konstatohet se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 67, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, miratimin e listave shumëemërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Aleanca Demokracia e Re, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, për të 12 zonat zgjedhore të vendit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Po, përfaqësuesi i Partisë Aleanca Demokracia e Re? Nuk kemi! Mirë, atëherë, bazuar në relatimin e administratës Komisionit Qendror të

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

Zgjedhjeve si dhe nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe pika 2, si dhe neni 67, 72, pika 1, 2 dhe 73, të Kodit Zgjedhor, të Republikës së Shqipërisë, si dhe udhëzimi nr.1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për përcaktimin e rregullave për depozitimin, verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit, si dhe shkronja “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr.138, 2015, për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, vendos: Miratimin e listave shumëemërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Aleanca Demokracia e Re, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për zonat zgjedhore, Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë, Qarku Shkodër, Qarku Tiranë dhe Qarku Vlorë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda tri ditëve, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr.161**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**18.03.2021  
Ora 11:41**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumëemërore të Partisë Bindja Demokratike, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:                                      **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto**
- **Parti Politike:**                                **BD (F.Topollaj), PBK (E.Alimadhi)**  
**Koalicione:**                                    **ALEANCA (D.Mullahaj), ABEOK (K.Papa)**

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Z.Y.Merkaj:** Partia Bindja Demokratike është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 dhe ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dokumentacionin për miratimin e listave shumëemërore, në datën 08.03.2021. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në datën 10.03.2021, ka vendosur kthimin për korrigjim, të dokumentacionit të listave shumëemërore të këtij subjekti politik. Brenda afatit ligjor, Partia Bindja Demokratike ka depozituar dokumentacionin e korrigjuar. Pas verifikimit të dokumentacionit të korrigjuar, konstatohet se është në përputhje me nenin 67 dhe 72, të Kodit Zgjedhor. Në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.138, të vitit 2015, ligji për dekriminalizimin, kandidatët për deputetë, të subjektit politik, Partia Bindja

**Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

Demokratike, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularët e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin dhe zbatimin, ndalimin dhe për zgjedhjen e emërimit dhe funksionimin ku përfshihet edhe funksioni i deputetit. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, konstatohet se, nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë, të cilat kanë të bëjnë me ndalimet për ligjet nr.138, të vitit 2015. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka kthyer përgjigje, ku konfirmon të dhënat e deklaruara nga kandidatët për deputetë, në formularët e tyre të vetëdeklarimit. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë. Referuar ligjit nr.138, të vitit 2015, të dhënat e deklaruara në formularët e vetëdeklarimit dhe informacioni i ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për kandidatët për deputetë, të subjektit politik, Partia Bindja Demokratike, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e tyre, si kandidatë për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021. Në këto kushte, i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, miratimin e listave shumëemërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Bindja Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, për të 12 zonat zgjedhore të vendit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Bindja Demokratike!

**Z.F.Topollaj, përfaqësues i Partisë Bindja Demokratike:** Jam dakord! S'kam diskutime!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, bazuar në sa u relatua, si dhe në nenin 19, pika 1, shkronja "n" dhe 2, neni 67, 72, pika 1 dhe 2 dhe neni 73, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020, të

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për përcaktimin e rregullave, për depozitimin, verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit, si dhe shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr.138, 2015, për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, vendos: Miratimin e listave shumëëmërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Bindja Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për zonat zgjedhore, Qarku Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda tri ditëve, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr.162**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**18.03.2021  
Ora 11:44**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumëemërore të Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

**1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      Z.Illirjan Celibashi**

**2.Stafi KQZ:    Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto**

- **Parti Politike:    BD (F.Topollaj), PBK (E.Alimadhi)**
- **Koalicione:    ALEANCA (D.Mullahaj), ABEOK (K.Papa)**

***Z.I.Celibashi:*** Vazhdojmë me pikën tjetër.

***Z.Y.Merkaj:*** Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021, dhe ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dokumentacionin për miratimin e listave shumëemërore. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në datën 10.03.2021, ka vendosur kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumëemërore të kandidatëve për deputetë, të subjektit politik, Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare. Brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare ka depozituar dokumentacionin e korrigjuar. Në mbështetje të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, është bërë verifikimi i listave shumëemërore të kandidatëve për deputetë të këtij subjekti zgjedhor dhe është

***Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

konstatuar se është në përputhje me kërkesat e parashikuara të nenit 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Në përputhje me nenin 5, të ligjit nr.138, të vitit 2015, kandidatët për deputetë, të subjektit politik, Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularët e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin dhe zbatimin e ndalimeve në lidhje me këtë ligj. Nga verifikimi i formularëve të deklarimit, konstatohet se, nuk kanë deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me parashikimet për ndalim, në ligjin nr.138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku nuk iu përgjigjën kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka kthyer përgjigje për kandidatët për deputetë, të cilët janë akoma, ende në proces verifikimi nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë. Referuar ligjit nr. 138, të vitit 2015, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për kandidatët për deputetë, të subjektit politik, Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare, *prima facie* nuk përbën kusht për mosregjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021. Nga verifikimi i dokumentacionit në tërësi, të listave shumëemërore konstatohet se është në përputhje me nenin 67, 72 dhe 73, të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, miratimin e listave shumëemërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, për 12 zonat zgjedhore të vendit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare, është prezent? Nuk është? Mirë! Atëherë, bazuar në sa u relatua, si dhe nenin 19,

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

pika 1, shkronja “n” dhe pika 2, neni 67, neni 72, pika 1 dhe 2, dhe neni 73, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit, si dhe shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr.138, 2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, vendos: Miratimin e listave shumëemërore të kandidatëve për deputetë, të Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për zonat zgjedhore, të qarqeve Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim, brenda tri ditëve, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, faleminderit!

**Vendimi nr. 163**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

18.03.2021

Ora 11:48

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumëmemërore të Partisë Balli Kombëtar, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Ilirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:                                      **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto**
- **Parti Politike:**                              **BD (F.Topollaj, PBK (E.Alimadhi)**
- **Koalicione:**                                      **ALEANCA (D.Mullahaj), ABEOK (K.Papa)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Partia Balli Kombëtar është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 dhe ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore në datën 08.03.2021. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 10.03.2021, ka vendosur kthimin për korigjim të dokumentacionit të listës shumëmemërore të këtij subjekti zgjedhor. Brenda afatit të përcaktuar Partia Balli Kombëtar ka depozituar dokumentacionin e korigjuar. Në mbështetje të nenit 78 të Kodit Zgjedhor Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e listave shumëmemërore ku është konstatuar se është në përputhje me kërkesat e parashikuara

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

në nenin 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.138 të vitit 2015, kandidatët për deputetë të subjektit politik Partia Balli Kombëtar kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi prima faca i formularëve të vetëdeklarimit kandidatëve për deputetë, rezulton se asnjë prej kandidatëve nuk ka deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me parashikimet për ndalimin e ligjit nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Gjyqësore dhe Zyra e Gjendjes Civile, ku në përgjigje të kërkesës sonë është kthyer përgjigja që verifikimi i gjendjes gjyqësore të kandidatëve për deputet është në proces verifikimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Referuar ligjit nr.138 të vitit 2015, të dhënat e deklaruara në formularin e deklarimit për kandidatë për deputetë të subjektit politik Partia Balli Kombëtar prima faca nuk përfshijnë në fushën e ndalimit të nenit 2 të ligjit nr.138 të vitit 2015. Pas verifikimit përkatëse konstatohet se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 67,72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor. Në mbështetje të neneve të mësipërme i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Balli Kombëtar për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë së datës 25 Prill 2021 për të 12 zonat zgjedhore të vendit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtimin dhe miratim, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Përfaqësuesi i Partisë Balli Kombëtar ka ndonjë gjë?

**Z. E. Alimadhi, përfaqësues i Partisë BK:** Faleminderit kryetar. Jam dakord me projektvendimin që ka bërë administrata, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Bazuar në relatimin e Administratës së KQZ-së, si dhe nenin 19, pika 1 shkronja “n” dhe pika 2, si dhe neni 67 72 pika 1 dhe 2, neni 73 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si Udhëzimi nr.1 datë 23.12.2020, Komisionerit Shtetëror për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit si dhe shkronjës “a”, të pikës 4 të nenit 5 të ligjit nr.138, 2015 për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksionet publike vendos:

Miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Balli Kombëtar për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi për zonat zgjedhore të qarqeve Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Korçë, Dibër, Kukës, Berat, Elbasan, Shkodër, Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr.164**

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



**18.03.2021  
Ora 11:51**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumëmemërore të Koalicionit ALEANCA për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:                                      Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto**
- **Parti Politike:                                      BD (F.Topollaj), PBK (E.Alimadhi)**
- **Koalicione:                                        ALEANCA (D.Mullahaj), ABEOK (K.Papa)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër.

**Z. Y. Merkaj:** Koalicioni ALEANCA – AL është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 dhe ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore në datën 08.03.2021. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 11.03.2021 ka vendos kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumëmemërore të kandidatëve për deputetë të subjektit zgjedhor Koalicioni ALEANCA. Brenda afatit ligjor Koalicioni ALEANCA ka depozituar dokumentacionin e korrigjuar. Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka verifikuar listat shumëmemërore të kandidatëve për deputetë të Koalicionit ALEANCA – AL dhe dokumentacioni bashkëlidhur dhe është konstatuar se nuk

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

është në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor. Në përfundim të procesit të verifikimit u ri konstatua mangësi dhe mos përmbushje të dokumentacionit. Koalicioni ALEANCA nuk ka paraqitur dokumentacion provues për plotësimin e kërkesave të nenit 68 të Kodit Zgjedhor. Koalicioni ka paraqitur vërtetim për zotërimin e dy mandateve në Kuvend. Partitë pjesëmarrëse të Koalicionit ALEANCA nuk vërtetoj se zotërojnë bashkërisht në Kuvend numër mandatesh jo më të vogël se sa numri pjesëmarrës i partive në koalicion. Gjithashtu nuk janë paraqitur listat mbështetëse me jo më pak se 7 mijë zgjedhës në shkallë Kombëtare. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve mos regjistrimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për deputetë të Koalicionit ALEANCA – AL për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

**Z. I. Celibashi:** Përfaqësues të këtij subjekti?

**Z. D. Mullahaj, përfaqësues i Koalicionit ALEANCA:** Po i nderuar zoti Kryetar, Dritan Mullahaj koordinator i Koalicionit ALEANCA. Ju lutem do të doja t'iu tërhiqja vëmendjen në tre pikat që variojnë tek propozimi për vendimin në lidhje me numrin e mandateve të Koalicioni ALEANCA. Partitë pjesëmarrëse në Koalicionin ALEANCA duke parë që nuk kishim mbështetje me numër mandatesh janë tërhequr nga sigla.. dhe listat e fundit që janë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhor janë me dy subjekte. Duke përmbushur kështu kushtin e subjekteve të mbështetura me numrin e mandateve. Ndërsa në lidhje me Modelin 05 në kthimin për korrigjim nuk është konstatuar i njëjti problem që po shfaqet aktualisht dhe është vazhduar me të njëjtin model plotësimi i Modelit 05. Që do të thotë u morë i mirëqenë që nuk kishte defekte në plotësimin e tij dhe vazhdoi i njëjti plotësim. Kurse në lidhje me dokumentet për kandidateve.. më



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

fal dokumentet e formularit të kandidatëve nga Koalicioni ALEANCA për shkak të tërheqjes të disa partive brenda koalicionit për mungesë numri të mandateve jemi të detyruar të bëjmë disa lëvizje nga qarku në qark për person.. të kandidatëve duke pretenduar se një pjesë e mirë e dokumentacionit mund të ketë mbetur nga qarku i mëparshëm për të kaluar në qarkun tjetër ku është zhvendosur kandidati. Unë do t'iu kërkoja të rishikonit edhe njëherë vendimin tuaj ose mundësin e ndonjë shtyrje të vendimit në lidhje me Koalicionin ALEANCA, ju faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Me sa kuptova ju po thoni që tashmë partitë pjesëmarrëse të këtij koalicioni nuk janë ato të regjistruara sipas vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Disa parti janë tërhequr dhe tërheqja e këtyre partive nga ky koalicion është bërë pasi KQZ ka marrë vendimin për regjistrimin e koalicionit. Këtë po thoni apo jo? Kështu është?

**Z. D. Mullahaj, përfaqësues i Koalicionit ALEANCA:** Shoqërimi.. listat e fundit të dërguara..


**Z. I. Celibashi:** Jo, nuk po flas për listat. Por, ju jeni regjistruar si subjekt zgjedhor si koalicion i përbërë nga 7 parti nëse nuk gaboj?

**Z. D. Mullahaj, përfaqësues i Koalicionit ALEANCA:** Po.

**Z. I. Celibashi:** Jeni duke thënë që nga 7 parti, 5 parti janë tërhequr nga ky koalicion?

**Z. D. Mullahaj, përfaqësues i Koalicionit ALEANCA:** Po.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

**Z. I. Celibashi:** Tani keni ngelur vetëm 2 parti?

**Z. D. Mullahaj, përfaqësues i Koalicionit ALEANCA:** Po.

**Z. I. Celibashi:** Tërheqja e këtyre partive është bërë pasi KQZ ka marrë vendimin për regjistrimin?

**Z. D. Mullahaj, përfaqësues i Koalicionit ALEANCA:** Partitë nuk janë tërhequr nga koalicioni, por partitë e kanë pasur të pamundur për shkak të mungesës së mbështetjes për të garuar nën siglën e tyre. Koalicioni përfaqësohet me dy sigla pavarësisht përbërjes së koalicionit. Sipas ligjit koalicioni përbëhet nga dy sigla. Domethënë pak a shumë ne përmbushim siglat me numrin e mandateve, ndërsa brenda koalicioni nuk ka ndryshuar.


**Z. I. Celibashi:** Edhe njëherë, numri i partive politike pjesëtare të koalicionit është 7? Aq sa ka përcaktuar vendimi i Komisioni Qendror të Zgjedhjeve bazuar në kërkesën tuaj për t'u regjistruar si koalicion?

**Z. D. Mullahaj, përfaqësues i Koalicionit ALEANCA:** Po.

**Z. I. Celibashi:** Po dhe vazhdojnë të jenë 7 parti anëtare të koalicionit, thoni ju. Por, nga këto 7 parti dy nuk e kanë pasur mundësinë për të marrë firma mbështetëse ose mandat mbështetës. Jeni dy parti praktikisht që keni plotësuar kushtet, thoni ju?

**Z. D. Mullahaj, përfaqësues i Koalicionit ALEANCA:** Po.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

**Z. I. Celibashi:** Dakord. Mirë faleminderit. Unë mendoj që për sa dhe vetë Ju konfirmuat por dhe nga ajo ç'ka u relatua nuk jeni në kushtet e përcaktuara nga ligji për t'u pranuar listat shumemërore të kandidatëve për deputetë për subjektin tuaj. Pasi subjekti zgjedhor juaj është një koalicion zgjedhor, i cili është miratuar. Pra, e ka fituar si të thuash personalitetin e tij juridik me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për regjistrim të këtij subjekti. Subjekti juaj është ky koalicion. Për më tepër që ju konfirmoni që vazhdoni të jeni 7 parti anëtare të koalicionit, po 5 prej këtyre partive nuk kanë qenë në mundësinë për të përmbushur kërkesat e ligjit.

**Z. D. Mullahaj, përfaqësues i Koalicionit ALEANCA:** Ju lutem, më lejoni të sqarohem, sepse.. parti pjesë e koalicionit janë ato parti për sa dorëzohen siglat në Komisionin Qendror. Ne mund të kemi mbështetje popullore, por nuk mund të merret kjo prioritet..


**Z. I. Celibashi:** Jo..

**Z. D. Mullahaj, përfaqësues i Koalicionit ALEANCA:** Ne po themi sipas ligjit në listën.., në përpilimin e listave janë dy sigla. Dy sigla mbështeten nga dy mandate.

**Z. I. Celibashi:** Po, por koalicioni me vendim të KQZ-së është tjetër subjekt. Ne po flasim për Koalicionin ALEANCA.

**Z. D. Mullahaj, përfaqësues i Koalicionit ALEANCA:** Po.

Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

**Z. I. Celibashi:** Koalicioni ALEANCA bazuar në vendimin e KQZ-së në vlerësim të kërkesës që kanë bërë partitë anëtare të këtij koalicioni ka konsideruar si subjekt zgjedhor Koalicionin ALEANCA dhe kjo është një çështje që është e përfunduar tashmë. Subjekti zgjedhor është subjekti ALEANCA dhe..

**Z. D. Mullahaj, përfaqësues i Koalicionit ALEANCA:** Po, vazhdojmë të jemi subjekti ALEANCA.

**Z. I. Celibashi:** Po, por do të duhet që subjekti ALEANCA.. Koalicioni ALEANCA të plotësojë kërkesat e ligjit si koalicion. Kështu që në vlerësim të çfarë u relatua dhe çfarë u diskutua. Si edhe bazuar në nenin 19-të pika 1 shkronja “n” dhe 2, neni 67, 72 pika 1 dhe 2 dhe 73 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Udhëzimit nr. 1 datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin, verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidatit”, si dhe shkronjës “a” të pikës 4 të nenit 5 të ligjit 138 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendos:

1. Refuzimin e listave shumemërore të Koalicionit ALEANCA për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimin mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Faleminderit!

**Vendimi nr. 165**

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

18.03.2021  
Ora 12:04

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqytimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të Partisë Aleanca Kombëtare, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:                                      **Y.Merkaj, M.Koja, O.Peto**
- **Parti Politike:**                                **BD (F.Topollaj), PBK (E.Alimadhi)**
- **Koalicione:**                                    **ALEANCA (D.Mullahaj), ABEOK (K.Papa)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër.

**Z. Y. Merkaj:** Partia Aleanca Kombëtare është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në bazë të nenit 67 dhe 71 të Kodit Zgjedhor ka paraqitur kërkesën pranë KQZ-së për miratimin e listave shumemërore në datën 8.03.2021 dhe KQZ ka verifikuar listën shumemërore dhe ka vendosur kthimin për korigjim të dokumentacionit të listës shumemërore të këtij subjekti zgjedhor. Brenda afatit partia nuk ka depozituar dokumentacionin e korigjuar. Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor Administrata e KQZ ka verifikuar listat dhe është konstatuar se nuk janë në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, 68, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor. Nuk ka sjellë vërtetim

*Zbardhi materialin e inçizuar*

*Silvi Sino*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021**

për zotërim mandati në Kuvend nuk ka sjellë listat mbështetëse si dhe nuk ka sjellë formularë të vetëdeklarimit të kandidatëve të listave shumemërore të kësaj partie. Në mbështetje të neneve të mësipërme i kërkojmë Komisionerit refuzimin e listave shumemërore të Partisë Aleanca Kombëtare, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Dje është komunikuar dhe me sekretarin e kësaj partie për seancën e sotme, ka marrë njoftim.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë bazuar në relatimin e bërë nga Administrata dhe nenit 19 pika 1 shkronja “n” dhe 2 si dhe neni 69, 71, 72, 73 të “Kodit Zgjedhor”, Udhëzimit numër 1 datë 23.12.2020 “Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve, miratimin e modeleve të kandidimit” si dhe shkronja “a” pika 4 neni 5 ligji 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendos:

1. Të refuzoj listat shumemërore të Partisë Aleanca Kombëtare, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Këto ishin çështjet në rendin e ditës. Seanca mbyllet, faleminderit!

**Vendimi nr.166**

**Zbardhi materialin e inçizuar  
Silvi Sino**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

18.03.2021  
Ora 12:00

**RENDI I DITËS**

**Projekvendim “Për shqytimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët , për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:                                      **Y. Merkaj, M.Koja, O.Peto**
- **Parti Politike:**                                **BD (F.Topollaj), PBK (E.Alimadhi)**
- Koalicione:**                                    **ALEANCA (D.Mullahaj), ABEOK (K.Papa)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër.

**Z. Y. Merkaj:** Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Në bazë të nenit 67 dhe 71 të Kodit Zgjedhor ka paraqitur kërkesën pranë KQZ-së për miratimin e listave shumemërore. Referuar nenit 73 të Kodit Zgjedhor KQZ ka verifikuar listën shumemërore dhe në datë 10.03.2021 ka konstatuar mangësi në dokumentacion dhe ka vendosur kthimin për korigjim të dokumentacionit të listës shumemërore të këtij koalicioni. Brenda afatit ligjor Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor ka depozituar dokumentacionin e korigjuar. Është bërë verifikim dhe është konstatuar që dokumentacioni është në përputhje me nenin 5 të ligjit të dekriminalizimit. Kandidatët për deputetë kanë depozituar pranë KQZ formularët e vetëdeklarimit

*Zbardhi materialin e inçizuar*

*Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021*

dhe nga verifikimi i formularëve rezulton se nuk kanë deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me ndalimin e ligjit nr 138 të vitit 2015. KQZ ka kërkuar informacion nga Zyra Gjyqësore dhe Zyra e Gjendjes Civile ku në përgjigjë të kërkesës tonë Drejtoria e Përgjithshme e Zyrës Gjyqësore ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës tonë në lidhje me verifikimet e të dhenave të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Nga verifikimi *Prima Face* i të dhenave të deklaruara në formularin e deklarimit për kandidatët për deputet Aleanca Bashkimi Popullor konstatohet se nuk përbëjnë kusht për mos regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Nga verifikimet përkatëse të dokumentacioneve në tërësi konstatohet se është në përputhje me nenin 67, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për deputetë të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit zoti Sekretar. Për diskutime, përfaqësuesi i koalicionit?

**Z. Sh. Kodhelaj, përfaqësues ABEOK:** Jemi njohur me parashtrimin që bëri KQZ dhe jemi plotësisht dakord me këtë vendim, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë bazuar në relatimin e bërë nga Administrata dhe nenit 19 pika 1 shkronja “n” dhe 2 si dhe neni 69, 71, 72,73 të “Kodit Zgjedhor”,

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Silvi Sino*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.03.2021**

Udhëzimit numër 1 datë 23.12.2020 “Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e listave të kandidatëve, miratimin e modeleve të kandidimit” si dhe shkronja “a” pika 4 neni 5 ligji 135 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendos:

- 1.Të miratoj listat shumemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 që bashkëlidhet këtij vendimi për zonat zgjedhore: Qarku, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokaster, Kukës, Korçë, Lezhë, Shkodër, Vlorë dhe Tiranë;
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së;
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, faleminderit.

**Vendimi nr.167**

**Zbardhi materialin e inçizuar  
Silvi Sino**

